VENDIM
Nr. 145, datë 11.3.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË SHIJAK, KAMZË, KAVAJË DHE KRUJË

(ndryshuar me vendimin nr. 794 datë 12.12.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 662 442 555 (një miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e katërqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara në bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë e Krujë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për Bashkinë Shijak, në masën 107 863 248 (njëqind e shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë;

b) Për Bashkinë Kamzë, në masën 23 600 000 (njëzet e tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë;

c) Për Bashkinë Kavajë, në masën 52 958 153 (pesëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë;

ç) Për Bashkinë Krujë, në masën 1 478 021 154 (një miliard e katërqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë, në masën 997 465 533 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 64 717 949 (gjashtëdhjetë e katër milionë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e nëntë) lekë;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 14 160 000 (katërmbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë;

c) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi, në masën 31 774 892 (tridhjetë e një milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë;

ç) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 886 812 692 (tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 52 585 299 (pesëdhjetë e dy milionë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Shijak dhe Kamzë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 43 145 299 (dyzet e tre milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 9 440 000 (nëntë milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Efekti financiar, për vitin 2022, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet bashkive Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj